



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 31, Datë 29.07.2014

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve (KMK) me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|---------|
| - Znj. Klotilda Neziri | Kryetar |
| - Znj. Ermonela Xhafa | Anëtar |
| - Z. Zamir Moçka (Stefani) | Anëtar |

në mbledhjen e tij të datës 29.07.2014, vazhdoi shqyrtimin e praktikave të bankave të nivelit dytë për fushën e kredisë konsumatorë.

Komisioni, pas shqyrtimit të informacionit përmbledhës, për gatitur nga Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorëve, përgjigjeve zyrtare të shkresës me nr. prot. 3125 datë 15.04.2014, drejtuar secilës prej bankave të nivelit të dytë, informacionit që përmbajnë faqet web respektive, si dhe mbajtjes së seancës dëgjimore me përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë dhe të Shoqatës së Bankave, në mbledhjen e datës 26.06.2014,

VËREN SE:

14 bankat e nivelit të dytë, të cilat ofrojnë kredi konsumatore, kanë mangësi në dhënien e informacionit në lidhje me këtë produkt, si në fazën e publicitetit ashtu edhe në fazën parakontraktore. Disa prej tyre përdorin në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me konceptin ligjor, termin “**kredi konsumatore**”. Mangësitë konsistojnë në dhënien e informacionit standard mbi elementë si: norma e huas, shumat e pagesave për këstet, shumat totale e pagesës për konsumatorin, norma efektive e interesit, mungesa e shembullit përfaqësues, mungesa e dhënies me shkrim të informacionit parakontraktor, përshkrimi i karakteristikave të produktit të kredisë, kostot e kredisë dhe aspekte të tjera ligjore, në kundërshtim me nenet 44 dhe 45 të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbështetur në nenet 44, 45, 52 pika 4, të Ligjit nr. 9902, date 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe pika 3 shkronja f, pika 6 shkronja a dhe b, pika 31 dhe 32 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”,

VENDOSI:

1. Bankat e nivelit të dytë të zbatojnë kushtet sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, kur kredia konsiderohet një kredi konsumatore;
2. Bankat e nivelit të dytë të marrin masat për mospërdorimin e termit “kredi konsumatore”, në rastet kur nuk plotësohen kushtet sipas dispozitave të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve” nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar,
3. Të merren të gjitha masat për përmirësimin e situatës në lidhje me dhënien e informacionit në fazën publicitetit dhe fazën parakontraktore, përpara ofrimit të një kredie konsumatore.
4. Bankat të njoftojnë Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve për zbatimin e këtij vendimi, brenda 2 muajve nga marrja e njoftimit të këtij Vendimi;
5. Publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

KRYETAR I KOMISIONIT

KLOTILDA NEZIRI